



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZIVE

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 22 dhe neni 20 paragrafi (1) nënparagrafët 1 dhe 10¹ të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24, dhe 193/24, në pajtim me nenin 54 paragrafi (4) dhe neni 104 paragrafi (4) nga Ligji i Procedurës së Përgjithshme Administrative (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.124/15), në lidhje me Propozimin PA1 nr.08-56 datë 14.02.2025 dhe Propozimin PA1 nr.08-56, datë 27.02.2025n në pajtim me Konkluzionin ark.nr.02-799/6, datë 28.02.2025 , Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive, në seancën e 9-të mbajtur më 28.02.2025, miratoi si vijon:

AKTVENDIM
për ndalimin e procedurës së inicuar për heqjen
e lejes për transmetim televiziv

NDALOHET procedura e inicuar për heqjen e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TELEVISIONI KOÇAN-LD SHPKNJP Koçan, PA1 nr.08- 44 datë 07.09.2023

A r s y e t i m

Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive (Agjencia) në seancën e 7-të mbajtur më 18.02.2025, me Konkluzionin nr.02-657/4 të datës 18.02.2025, miratoi propozimin e dr. Zoran Trajçevski, Drejtor i Agjencisë, PA1 nr.08-56 datë 14.02.2025 dhe ka inicuar procedurë për heqjen e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TELEVISIONI KOÇAN-LD SHPKNJP Koçan, PA1 nr.08-44 datë 07.09.2023, për shkak se pas mbikëqyrjes së rregullt administrative, në Raportin me shkrim ark.nr.05-663/1 datë 14.02.2025, është konstatuar se transmetuesi në afatin ligjor prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të faturës së dhënë nga Agjencia, nuk ka përmbushur detyrimin nga neni 80 paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LSHMAAV), përkatësisht nuk ka paguar kompensimin vjetor të lejes për transmetim televiziv Agjencisë.

Lidhur me këtë, nga Agjencia me datë 19.02.2025, drejtuar transmetuesit në fjalë është dërguar Shkresë PA1 nr.08-56 datë 19.02.2025, për njoftim se nëse nuk paguan kompensimin vjetor të lejes për transmetim televiziv, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të Propozimit



**Agjenci për shërbime
mediatike audio dhe
audiovizive**

**rr. Maqedonia nr 3 8
1000 Shkup
Republika e
Maqedonisë së Veriut**

tel. + 389 2 3103 400

**www.avmu.org.mk
www.avmu.mk
contact@avmu.mk**



¹ Paragrafët 8 dhe 9 janë fshirë , shih: Nenin 8 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 248/18).



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZIVE

për inicimin e procedurës për heqjen e lejes, do të miratojë vendim për heqjen e lejes për transmetim televiziv.

Megjithatë, më 27.02.2025, drejtuar Drejtorit të Agjencisë, nga Sektori për financa dhe logjistikë, është dorëzuar Njoftim ark.nr.05-663/2 datë 27.02.2025, se Shoqëria Tregtare Radiodifuzive TELEVISIONI KOÇAN-LD SHPKNJP Koçan, më 26.02.2025, ka kryer pagesë në shumë prej 118.842,00 (njëqind e tetëmbëdhjetë mijë e tetëqind e dyzet e dy) denarë, me çka kompensimin vjetor të lejes për transmetim televiziv e ka paguar në tërësi.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 22 dhe neni 20 paragrafi 1 nënparagrafët 1 dhe 10² nga LSHMAAV, në pajtim me nenin 54 paragrafi (4) dhe neni 104 paragrafi (4) nga Ligji i Procedurës së Përgjithshme Administrative, në lidhje me Propozimin PA1 nr. 08-56 datë 14.02.2025 dhe Propozimin PA1 nr. 08-56 datë 27.02.2025, në pajtim me Konkluzionin ark.nr.02-799/6 datë 28.02.2025, Këshilli i Agjencisë, në seancën e 9-të mbajtur më 28.02.2025, vendosi të ndalon e procedurës e inicuar për heqjen e lejes.

Bazuar nga sa më sipër u mor aktvendim si në dispozitiv.

Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizive
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për inicim të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për fillimin e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

² Paragrafët 8 dhe 9 janë fshirë , shih: Nenin 8 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizive (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 248/18).